

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “E&A 25” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 13.02.2025, ne te poshtëshënuart;

Armela Karaj, e datëlindjes 05.03.2000, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ID K053050670:

Endi Fejzo i datëlindjes 14.04.1999, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ID J90414060E. Me cilësinë e “ortakeve themelues” deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“E&A 25” shpk.**

Neni 1. Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“E&A 25” shpk** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria **“E&A 25” shpk** e ka seline në adresë: Tirane, Kamez, Babrru, Rruga Azem Galica, Ndertese private me numer pasurise 1017/2, Zona Kadastrale 1066 dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë **“E&A 25” shpk** është; Agjensi shërbimesh dhe pagesa utilitare.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 2,600,000(dymilioneegjashteqindmije) lekë, i ndarë në 2(dy) kuota te cilat zotërohet si më poshtë:

Armela Karaj, e datëlindjes 05.03.2000, lindur dhe banuese në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti , me numër personal ID K05305067O zoteron 1(nje) kuote ose 50% te kalitalit te shoqerise.

Endi Fejzo i datëlindjes 14.04.1999, lindur dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti , me numër personal ID J90414060E zoteron 1(nje) kuote ose 50% te kalitalit te shoqerise.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 **Administrimi**

Administrator i shoqërisë **"E&A 25" shpk** është: Endi Fejzo i datëlindjes 14.04.1999, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ID J90414060E. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5 (pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 13.02.2025. Afati i emerimit të administratorit është deri me 13.02.2030.

Neni 10 **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11 **Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare **"E&A 25" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

Armela Karaj

Endi Fejzo

Tiranë, më datë 13.02.2025

